



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:217385

Datë: 12.11.2021

Numri i dokumentit: 02393081

**PKR.nr.143/21**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda**, kryetari i trupit gjykues Shaqir Zika, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit P. (S.) Z. nga fshati . . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.192/2021 të dates 05.10.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 25.10.2021, në prezencën e Prokurorës së shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mur dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 12.11.2021 përpilojë këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**P. Z.**, nga i ati S. dhe ëma Z. e gjinisë B., data e lindjes . . . , në fshatin . . . , K.Malishevë, ku edhe banon, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 4 fëmijëve, punëtorë, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal. . .

### Ë S H T Ë F A J T O R

I.Nga data e pa vërtetuar deri me datë 14.09.2021, në fshatin . . . K.Malishevë, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 Ligjin mbi armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyre që patrulla policore në pikë kontroll në rr.”. . .” në fshatin e cekur më lartë, kanë ndalë automjetin e tipit “. . .”, me targa . . . , ngjyrë e kaltër, të cilin po e drejtonte i pandehuri dhe ky i fundit menjëherë kishte pranuar se posedonte armë dhe atë në brez prapa shpinës i gjejnë armën-pistoletë të tipit Wallter 9 mm, prodhim gjerman, me numër serik: 9033 me një (1) karikatorë dhe tetë (8) copë fishekë të kalibrit 9x19 mm e cila më pas është konfiskuar nga ana e Policisë.

- **Me këto veprime ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.**

**II.** Në dimër të vitit 2019, në fshatin . . . K.Malishevë, përdor armën në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që i njëjti armën-pistoletë të tipit Wallter 9 mm, prodhim gjerman, me numër serik 9033, të cilën e ruante kujtim nga babai, dhe të njëjtën armë në vendin dhe kohën e cekur më lartë e kishte përdorë në mënyrë që ta dinte se a është funksionale dhe atë duke shtënë një herë në drejtim të ajrit, e cila armë është sekuestruar nga ana e policisë.

- **Me këto veprime ka kryer veprën penale, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe nenit 366 par.1, nenit 367 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 dhe 366 të KPPK-se, të akuzuarin e :

## G J Y K O N

**Për dispozitivin I të akuzës,** për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-se, **ME DENIM ME GJOBË** në shume prej tetëqind (8000) €, të cilin dënim duhet ta paguaj në afate prej tredhjet (30) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të behet i formës së prere.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobe, atëherë Gjykata të akuzuarit ja zëvendëson dënimin me gjobe në dënim me burgim në kohëzgjatje prej dyzet (40) dite, duke llogaritur çdo ditë të kaluar në burgim nga njëzet (20) Euro.

**Për dispozitivin II të akuzës** për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se, **ME DENIM ME KUSHT** duke ia vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale,

Ndaj të akuzuarit P. Z. i **konfiskohet:** armën-pistoletë të tipit Wallter 9 mm, prodhim gjerman, me numër serik: 9033 me një(1) karikatorë dhe tetë (8) copë fishekë të kalibrit 9x19 mm, si objekte të veprës penale.

**Urdhërohet** Stacioni Policor në Malishevë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armëve të konfiskuar dhe municionit, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2021-ED-554.

**Detyrohet** i akuzuari, që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP/L.nr.192/2021 të dates 05.10.2021, kundër të akuzuarit P. (S.) Z. nga fshati . . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestare me datë 25.10.2021, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, si dhe i akuzuari P. Z..

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar të akuzuarin e ka udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tija konform nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimit të akuzuarit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit.

Pas leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestarë, Gjykata është bindur se i akuzuari ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë, kështu që pas shpjegimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, i akuzuari P. Z., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet dhe shton se e ndej veten fajtori, armën e ka pasur kujtim nga i ati i tij, të njëjtën asnjëherë nuk e ka keqpërdorë dhe është e vërtetë që ditën kritike arma i është gjetur në posedim, e po ashtu në vitin 2019 një herë me këtë armë ka shtënë në ajër, andaj i ka propozuar gjykatës që ti shqiptohet një dënim më i butë, është mbajtës i vetëm i familjes, atë i katër fëmijëve, dhe ekzistencën e siguron nga puna fizike, dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla të ngjashme penale.

Pas deklarimit të akuzuarit për pranimin e fajësisë, Kryetari i trupit gjykues kërkoj që mendimin e vet ta jep Prokurorja e shtetit.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni duke dhënë mendim për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë pas shpjegimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në prova në të cilat bazohet aktakuza dhe për këto arsye i propozoi gjykatës që të aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

### 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në P. me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas shpjegimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë

shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari P. Z.i, me dashje ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv I dhe II të këtij Aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

Në nenin 367 paragrafi 1 të KPRK-se, është parashikuar se formën themelore të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm kryhet: “*kush do që përdor armë apo materiale plasëse në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiale plasëse të tilla, dënohet me burgim prej 1 ( një ) deri në 8 ( tete ) vjet.*”

### 5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarin P. Z., e ka shpallur fajtor për veprat penale nën dispozitivin I dhe II, për të cilën është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv I dhe II të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par 1 të KPRK-se dhe, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: se i akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes, i atë i 4 fëmijëve, në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilat ngarkohet, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër tjetër penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitivet e këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe se dënimet e shqiptuara me kusht dhe gjobe

sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se me dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi mbi konfiskimin e armës

Gjykata ndaj të akuzuarit P. Z., ka konfiskuar armët dhe municionet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si objekt i veprës penale konform nenit 366 par.3 dhe më pas ka urdhëruar Stacionin Policorë në Malishevë që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armëve dhe municionit.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm - PKR.nr.143/2021, me datë 12.11.2021**

**Sekretare juridike,  
Nushe Kadrija**

**Kryetari i trupit gjykues,  
Shaqir Zika**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.